



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim
Uprava za Obrazovanje/Department of Education

Data/Datum/Date:	18.08.2021
NR./Br./Nr:	05/376
Nga/Od/From	Agime Hasani Roshaj- Drejtoreshë e Arsimit
Lënda/Predmet/Subjekt	Vendim



Duke u bazuar në nenin 62, paragrafi 62.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, në bazë të nenit 13 të Rregullorës 01 Nr.06/570-060 për Ndarjen e Bursave për Studentë, pas përpilimit të listave nga Komisioni Komunal për Ndarjen e Bursave për Studentë, Drejtoria Komunale e Arsimit merr:

VENDIM

- Nuk aprovohet lista e propozuar nga Komisioni për Përzgjedhjen e listës Përfituese të Studentëve.
- Të rishpallet Konkursi për Ndarjen e Bursave për Studentë në përputhje me Rregullorën e Kuvendit sipas kriterëve ligjore në Rregullore.

ARSYETIM

Këtij vendimi i ka paraprirë mospërmbushja e kriterëve të aplikuesve, ngase sipas konkursit të shpallur me datë 14.07.2021, me nr. të protokollit 05/339, konstatohet se në 6 drejtime si Fakulteti i Makinerisë, Fakulteti i Arteve, Fakulteti i Shkencave Sportive, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës, Fakulteti Filozofik dhe Fakulteti Ekonomik, nuk ka pasur studentë që kanë aplikuar, me këtë rast edhe komisioni e ka pasur të pamundur të bëjë ndarjen e bursave në mënyrë meritore. Me këtë rast, do të rishpallet konkursi në përputhje me Rregullorën nr. 06/570-60, në mënyrë që të jetë në përputhje me parimin e ligjshmërisë, dhe meritës. Duke u bazuar në raportin e Komisionit dhe në identifikimin e mangësive procedurale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.